

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-005/14

Prishtinë

21 tetor 2015

Në çështjen juridike të:

D. S.

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetari i Kolegjit, Rolandus Bruin dhe Krassimir Mazgalov, gjyqtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/199/2013, të datës 18 prill 2013 (lënda e regjistruar në AKP me numër 31500), pas shqyrtimit të mbajtur më 21 tetor 2015 mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Pranohet ankesa e Dušanka Stojanović kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/199/2013, për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numër KPA31500.
2. Anulohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/199/2013, për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numër KPA31500.
3. Hidhet poshtë kërkesa e Dušanka Stojanović, për shkak të mungesës së juridiksionit të KKPK-së.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 3 gusht 2007, D. S. (në tekstin e mëtejme: paraqitësja e kërkesës), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), në emër të babit të saj të ndjerë, D. D., duke theksuar se babai i saj është pronar i ngastrës kadastrale nr.362, me sipërfaqe të përgjithshme prej 00.19.40 ha, e cila përbëhet nga shtëpia me sipërfaqe prej 80 m², oborri në sipërfaqe prej 00.05.00 ha dhe kulloja në sipërfaqe prej 00.13.60 ha (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar). Prona e kërkuar ndodhet në fshatin Rufc i vjetër, komuna e Lipjanit. Paraqitësja e kërkesës kërkon ri-posedimin e pronës duke pretenduar se posedimi është humbur për shkak të rrethanave të ndërlidhura me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë, në vitet 1998/99, duke cekur 17 qershor 1999, si datë të humbjes.
2. Për të mbështetur kërkesën e saj, ajo ka dorëzuar në AKP, këto dokumente:
 - Certifikatën e martesës nr. 4, në emër të D. D., të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil, komuna e Fushë Kosovës, që konfirmon lidhjen familjare me D.D..

- Fletën poseduese nr. 40 të lëshuar më 3 gusht 2007, nga Enti Gjeodezik i Serbisë, Qendra për Kadastër dhe Pronë në Lipjan, ku prona e kërkuar ishte e regjistruar në emër të D. D., si pronar i vetëm.
 - Certifikatën e vdekjes nr. 203-19/08-08-176, të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil në komunën e Lipjanit, më 15 janar 2008, që tregon se D. D. ka vdekur më 9 shtator 1996.
 - Letër-propozimin e D. S., për Gjykatën Komunale në Prishtinë, në lidhje me iniciimin e procedurës trashëgimore pas vdekjes së babait të saj.
3. Fleta poseduese nr.40, dhe certifikata e martesës janë verifikuar pozitivisht nga njësia verifikuese e AKP-së.
 4. Më 22 tetor 2007, AKP-ja ka bërë identifikimin e kërkesës duke vendosur një shenjë te vendi ku pretendohet se ndodhet ngastra, ku theksohej se prona ishte subjekt i kërkesës dhe se palët e interesuara duhet të paraqesin përgjigjet e tyre brenda 30 ditëve. Askush nuk ka paraqitur përgjigje ndaj këtij njoftimi.
Më 31 gusht 2010, AKP-ja e bëri përsëri identifikimin e pronës duke e publikuar në Gazetën për Njoftim nr.8 dhe në Buletinin e zyrës për prona të UNHCR-it. Gazeta dhe Lista i janë lënë kryetarit të fshatit Rufc i vjetër, i cili u pajtua t'ia dorëzojë palëve të interesuara dhe ta vendos në hyrje të fshatit Rufc i vjetër. Të njëjtat publikime janë lënë edhe në Gjykatën Komunale, Zyrën Kadastrale dhe komunën e Lipjanit dhe në Zyrën Regjionale në Prishtinë, në zyrat qendrore të UNHCR-it, Ombudspersonit, AKK, KDR dhe në Zyrën e UNMIK-ut në Graçanicë.
 5. Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK), me vendimin e vet KPCC/D/R/16/2008, të datës 30 prill 2008, ka vendosur t'ia vërtetojë të drejtën pronësore paraqitëses së kërkesës pasi që ajo e ka dëshmuar se D. D. ishte pronari i pronës dhe hapësirës rrethuese, në datën e shkatërrimit të pronës, kështu që, D. S., ka të drejtën e posedimit të pronës në fjalë.
 6. Me vendimin nr. KPCC/RES/17/2010, të datës 8 mars 2010, KKPK-ja ishte informuar nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së, se kërkesa nuk është proceduar siç duhet nga Sekretaria apo më saktë prona e kërkuar nuk është identifikuar siç duhet dhe se Komisioni nuk është informuar për këtë fakt. Kërkesa është kthyer te Sekretaria Ekzekutive e AKP-së për procedim të më tutjeshëm duke bërë njoftimin korrekt të pronës.
 7. Më 25 janar 2011, AKP-ja e bëri edhe një herë identifikimin e pronës por kësaj radhe duke vizituar pronën e cila u gjetur të jetë tokë kultivuese e uzurpuar nga një person i panjohur.

8. Brenda afatit prej 30 ditëve, në pajtim me nenin 10.2 të Ligjit nr. 03/L-079, asnjë palë nuk ka shprehur interesim të marrë pjesë në procedurë lidhur me pronën e cila është subjekt i kërkesës.
9. Nga provat në dosje është vërtetuar se më 26 mars 2013, paraqitësja e kërkesës është kontaktuar nga Sekretaria Ekzekutive. Ajo ka konfirmuar se babai i saj e ka shitur pronën e kërkuar te komshiu i tij para 17 vite, por bartja e së drejtës pronësore nuk është kryer, kështu që, prona ende mbetet në emër të babait të saj.
10. Me vendimin e vet të datës 18 prill 2013 (KPCC/D/R/199/2013), Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK), ka vërtetuar se paraqitësja e kërkesës fillimisht ka pretenduar se ajo apo familja e saj e ka humbur pronën e kërkuar si rezultat i konfliktit të viteve 1998-1999. Sidoqoftë, paraqitësja e kërkesës më pas e ka informuar Sekretarinë Ekzekutive se ajo apo familja e saj ka hequr dorë vullnetarisht nga prona e kërkuar para konfliktit të viteve 1998/1999; kështu që, kërkesa duhet të refuzohet.
11. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar paraqitëses së kërkesës më 27 gusht 2013.
12. Paraqitësja e kërkesës (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) ka paraqitur ankesë më 26 shtator 2013.

Pretendimet e palës ankuese

13. Pala ankuese e kundërshton vendimin e KKPK-së me arsyetimin se prona e kërkuar është shitur në mënyrë të paligjshme nga N. R., te një blerës, i cili është i përkatësisë etnike shqiptare, gjë që N. R. e ka bërë pa dijeninë dhe pëlqimin e askujt.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

14. Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afati prej 30 ditëve të përcaktuar me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079.

Juridiksioni

15. KKPK-ja nuk ka juridiksion që ta shqyrtojë kërkesën.
16. Në pajtim me nenin 3, paragrafi 1, nën-paragrafi a) dhe b) të Ligjit nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë të kërkojë vërtetimin dhe ri-posedimin e pronës së kërkuar, kur ai/ajo jo vetëm se e vërteton të drejtën e tij/saj me prova të dokumentueshme dhe të vlefshme, por ai/ajo nuk është në gjendje që tani t'i ushtrojë të drejtat e tij/saj pronësore për shkak të rrethanave të ndërlydhura drejtpërdrejt apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur gjatë viteve 98-99.
17. Gjykata Supreme konsideron se në bazë të deklaratës së saj, pala ankuese ka dështuar të provojë se kërkesa e saj përshinë rrethana të ndërlydhura apo që rezultojnë nga konflikti gjatë viteve 98-99. Në vazhdim, Gjykata Supreme konsideron se humbja e posedimit ishte rezultat i tjetërsimit vullnetar të kësaj prone duke e shitur para konfliktit, pasi që vet pala ankuese ka thënë se babai i saj ia ka shitur pronën komshiut të tij para 17 viteve.
18. Raste si këto nuk janë në juridiksion të KKPK-së; ato duhet të gjykohen nga gjykatat e rregullta kompetente civile. Në arsyetimin KKPK i referohet rrethanave që kanë ndodhur para konfliktit, megjithatë refuzon kërkesën. Në rastin aktual duhet të hidhet poshtë
19. Në bazë të asaj që u tha më lartë dhe në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Ligjit 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.
20. Vendimi i gjykatës nuk përmban paragjykime mbi të drejtën e palës ankuese për të kërkuar vërtetimin e të drejtës pronësore para autoriteteve kompetente vendore.

Këshillë juridike

21. Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i kolegjit

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it